

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**MISIONI NË KOSOVË**

**Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së  
politikave për riintegrimin e personave të  
riatdhesuar në komunat e Kosovës**

Shtator 2011

***Mohim përgjegjësie:***

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

## **PASQYRA E PËRMBAJTJES**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
1. HYRJE .....	4
2. ZHVILLIMET INSTITUCIONALE DHE TË POLITIKAVE NË NIVELIN QENDROR .....	5
A) Themelimi i bordit ekzekutiv dhe institucioneve vartëse .....	5
B) Rishikimi i kornizës së politikës për riintegrimin e personave të riatdhesuar .....	6
C) Themelimi i fondit qendror të riintegrit .....	7
3. ZHVILLIMET INSTITUCIONALE NË NIVEL LOKAL .....	7
A) Rregullorja për Zyrat komunale për Komunitete dhe Kthim .....	8
B) Themelimi i Zyrave komunale për komunitete dhe kthim .....	9
4. PËRPARIMI/NDIKIMI NË NIVEL LOKAL .....	9
A) Vetëdija e përgjithshme e zyrtarëve komunalë mbi politikat, rolet dhe përgjegjësitë .....	10
B) Bashkërendimi dhe bashkëpunimi në nivelin lokal dhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal .....	12
C) Mirëmbajtja e bazës së të dhënave/mbledhjes së të dhënave .....	13
D) Identifikimi i nevojave prioritare dhe zhvillimi i strategjive, programeve dhe procedurave komunale .....	14
E) Masat për ndihmë të ndërmarra nga komunat .....	15
5. PËRFUNDIME .....	18
6. REKOMANDIMET .....	19

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport shqyrton përparimin e arritur nga institucionet e Kosovës, e në veçanti komunat, në përmbushjen e obligimeve të tyre sipas kornizës ekzistuese të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Ky raport është vazhdimësi e publikimit të raportit të mëhershëm të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misionit në Kosovë (OSBE), të quajtur *Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, botuar në nëntor të vitit 2009. Ky raport përcjellës shënon ndryshimet që janë bërë në politikat dhe kornizën institucionale të riatdhesimit në periudhën e ndërmjetme, si dhe vlerëson ndikimin e këtyre ndryshimeve në nivel lokal. Ai është i bazuar në aktivitetet e monitorimit të rregullt të OSBE-së në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve.

Ky vlerësim ka vërejtur një masë përparimi në politikën e riatdhesimit qysh prej botimit të raportit të mëparshëm të vitit 2009. Mes janarit 2010 dhe korrikut 2011, qeveria ka miratuar strategjinë e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe planin përkatës të veprimit në bazë të vlerësimit të nevojave dhe analizës së mangësive, të kryer në fillim të vitit 2010. Korniza e rishikuar e politikës mëton të udhëzojë veprimtarinë e bashkërendimit dhe menaxhimit në të gjitha nivelet e qeverisë, me qëllimin e përgjithshëm të sigurimit të riintegrimin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës. Për t'i përforcuar përpjekjet e bashkërendimit, qeveria ka themeluar një bord ekzekutiv koordinues ndërministror, me detyrë mbikëqyrjen dhe monitorimin e implementimit të politikave ekzistuese, si dhe bashkërendimin e përpjekjeve të riintegrimin ndërmjet dhe mospërmes agjencive qeveritare. Për më tepër, në nivel lokal, zyrat komunale të komuniteteve dhe zyrtarët komunalë të kthimit kanë fituar një status më solid ligjor brenda zyrave komunale për komunitete dhe kthim. Përfundimisht, është grumbulluar një fond i nivelit qendror, si dhe për herë të parë, janë zotuar resurse buxhetore për zbatimin e masave për riintegrim.

Megjithatë, përkundër përparimit të dukshëm në hartimin e politikave dhe themelimin e mekanizmave institucionale, zbatimi i strategjisë qeveritare vazhdon të mbetet prapa. Derisa janë bërë përpjekje nga ana e autoriteteve të nivelit qendror për të ngritur vetëdijen dhe për t'i ngritur kapacitetet e zyrtarëve përgjegjës komunalë në lidhje me politikat dhe planet ekzistuese të veprimit, në shumë komuna, këta të fundit nuk kanë ecur drejt masave konkrete të riintegrimin. Ngjashëm, gjersa nismat për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe mes organeve përkatëse komunale janë intensifikuar në muajt e fundit, komunat shpeshherë nuk e shfrytëzojnë asistencën në dispozicion, apo kanë mungesë të vullnetit politik dhe/ose kapaciteteve për zbatimin e kornizave politike efektive. Rrjedhimisht, personat e riatdhesuar vazhdojnë të përballen me pengesa madhore në riintegrimin e tyre të qëndrueshëm si pasojë e qasjes së tyre praktikisht të kufizuar në pronë dhe banim, bashkë me vështirësitë në qasjen në shërbimet themelore, si arsimi, shëndetësia, punësimi dhe mundësitë ekonomike. Ka nevojë për masa më të forta në gjitha nivelet e qeverisjes, për ta përforcuar zbatimin e politikave dhe strategjive të riintegrimin, me synim përfundimtar sigurimin e kushteve të qëndrueshme dhe stabile të jetesës për personat e riatdhesuar.

## 1. HYRJE

Si pjesë e mandatit të saj të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në Kosovë, më 2009 OSBE-ja kishte bërë një vlerësim të kushteve për pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar<sup>1</sup> në komunat e Kosovës.<sup>2</sup> Ai vlerësim kishte gjetur se janë ndërmarrë pak hapa në zbatimin e kornizës ekzistuese të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivel lokal. Masat konkrete për lehtësimin e këtij procesi mungonin në fushat kyçe të shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe banimit, si dhe nuk është përfshirë asnjë kosto e ndërlidhur në asnjë buxhet komunal. Për më tepër, vlerësimi kishte zbuluar mungesë të vetëdijes tek zyrtarët komunalë përkatës për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e riintegrit, si dhe mungesë të këmbimit të mirëfilltë të informatave dhe mungesë të mekanizmave koordinues në nivel komunal, por edhe mes nivelit qendror dhe atij komunal. Si rezultat i këtyre mangësive, personat e riatdhesuar shpesh liheshin pa ndonjë ndihmë kuptimplote pas kthimit të tyre në Kosovë.

Qysh prej botimit të raportit të vitit 2009, riatdhesimet e detyruara nga vendet nikoqire (kryesisht në Evropën Perëndimore) kanë vazhduar të ndodhin.<sup>3</sup> Sipas statistikave të përpiluara nga Komisioni i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR)<sup>4</sup>, gjithsej 1334 persona janë riatdhesuar me forcë në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 2011, duke përfshirë 336 anëtarë të komuniteteve joshumicë<sup>5</sup> (303 nga ta i përkasin grupeve të konsideruara si të rrezikuara, si dhe në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nga UNHCR, gjegjësisht serbë, shqiptarët në vendet ku janë pakicë në nivel komunal, si dhe romë, ashkali dhe egjiptianë).<sup>6</sup> Përsëri sipas UNHCR-së, viti 2010 shënoi kthimin e pavullneshëm të 2,910 individëve, në krahasim me numrat prej 2,962 më 2009, 2,550 më 2008, 3,219 më 2007, 3,569 më 2006 si dhe 3,554 më 2005<sup>7</sup>.

<sup>1</sup> Sipas Strategjisë së rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar (maj 2010), riatdhesimi apo kthimi i detyruar ka të bëjë me personat nga Kosova, të cilëve iu është refuzuar statusi i refugjatit apo ndonjë status tjetër ligjor në vendet nikoqire, si dhe të cilët janë riatdhesuar drejt Kosovës me urdhra zyrtarë apo vendime gjyqësore.

<sup>2</sup> Raporti i OSBE-së: *Zbatimi i strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, nëntor 2009, <http://www.osce.org/kosovo/40180> (qasur më 23 gusht 2011).

<sup>3</sup> Qysh prej nëntorit të vitit 2008, qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje riatdhesimi me disa vende në rajon dhe Evropë Perëndimore, duke përfshirë këtu Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Republikën e Çekisë, Danimarkën, Francën, Gjermaninë, Luksemburgun, Malin e Zi, Holandën, Norvegjinë, Slloveninë dhe Zvicrën, derisa të tjera marrëveshje janë duke u negociuar. Ligji nr. 03/L-208 për Riatdhesimin, i datës 12 korrik 2010, përcakton rregullat dhe procedurat në lidhje me procesin e riatdhesimit në Kosovë.

<sup>4</sup> Më 6 qershor 2011, OSBE-ja ka nënshkruar një Marrëveshje Teknike (MT) me UNHCR për zbatimin e mëtejshëm të Memorandumit të Mirëkuptimit për Avancimin e Bashkëpunimit ndërmjet UNHCR dhe Sekretariatit të OSBE-së, i nënshkruar në Vjenë më 15 qershor 1998. MT përcakton kornizën e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e monitorimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e personave në shqetësim, duke përfshirë, mes të tjerëve, refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerit (vullnetarë dhe të detyruar), apatridët, komunitetet që përbëjnë pakicë numerike në një komunë të caktuar, si dhe personat e tjerë me shqetësime të përbashkëta.

<sup>5</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë, me termin komunitete jo-shumicë, nënkupton komunitetet të cilat janë pakicë në nivelin komunal.

<sup>6</sup> Shih UNHCR, Udhëzuesi për kualifikim i UNHCR-së për vlerësimin e nevojës për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova, HCR/EG/09/01, 9 nëntor 2009, dhe UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë/Priština, Pasqyrë Statistikore – freskuar në fund të marsit 2011 (vënë në dispozicion nga UNHCR).

<sup>7</sup> Shifrat qeveritare për të njëjtën periudhë janë: 1,569 më 2011 (janar-korrik); 2,095 më 2010, 3,225 më 2009, 2,556 më 2008, 2,945 më 2007, 2,378 më 2006, 2,987 më 2006. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB),

Riintegrimi i tyre i qëndrueshëm vazhdon të jetë sfidë madhore për institucionet në Kosovë, sidomos për komunat.

Ky raport vlerëson përpjekjet që janë bërë nga institucionet në Kosovë për t'u përballur në mënyrë efektive me mangësitë e gjetura, si dhe për të vendosur mekanizmat e domosdoshëm për të mundësuar riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunat e tyre të origjinës. Ky raport bazohet në aktivitetet e rregullta të monitorimit të OSBE-së në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në periudhën janar 2010-korrik 2011, si dhe në intervistat e kryera me zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve në shkurt-mars dhe në korrik të vitit 2011. Së pari ky përshkruan zhvillimet më të reja në politika dhe institucione, me qëllim të përmirësimit të reagimit në fushën e pranimit dhe riintegritimit të personave të riatdhesuar, e pastaj përshkruan zhvillimet institucionale në nivel komunal, duke u përqendruar veçanërisht tek zyrat për komunitete dhe kthim. Pjesa në vijim shqyrton ndikimin e këtyre zhvillimeve në politika e institucione në nivelin lokal, si dhe shqyrton përpjekjet komunale në zbatim të strategjive qeveritare. Pastaj, pjesa e fundit paraqet përfundimet dhe rekomandimet e synuara për përmirësimin e reagimit institucional ndaj riintegritimit të qëndrueshëm.

## **2. ZHVILLIMET INSTITUCIONALE DHE TË POLITIKAVE NË NIVELIN QENDROR**

Qysh prej botimit të raportit të OSBE-së në nëntor të vitit 2009, institucionet e nivelit qendror kanë bërë hapa drejt shqyrtimit të kushteve ekzistuese dhe politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Ato kanë bërë edhe përpjekje për të themeluar mekanizmat e nevojshëm institucionalë dhe procedurat për bashkërendimin e mbështetjes së qëndrueshme për personat e riatdhesuar.

### **A) Themelimi i bordit ekzekutiv dhe institucioneve vartëse**

Në prill të vitit 2010, qeveria themeloi një bord koordinues ndërministror (bord ekzekutiv), për të mbikëqyrur dhe monitoruar zbatimin e kornizës së politikës për riintegrimin e personave të riatdhesuar.<sup>8</sup> Anëtarësia e bordit ekzekutiv përbëhet nga përfaqësuesit e ministrive përkatëse<sup>9</sup>, si dhe përfaqësuesit nga organizatat ndërkombëtare<sup>10</sup> dhe përgjegjësitë themelore të tij përfshijnë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kornizës qeveritare të politikave për riintegrimin e

---

“Personat e riatdhesuar ndërmjet 2005 dhe 31 korrik 2011”. Për më shumë informata lidhur me DSHAM shih fusnotën 11 më poshtë.

<sup>8</sup> Vendimi i Qeverisë nr. 7/123, 30 prill 2010. Shih edhe: Misioni i Përkohshëm i OKB-së për Administratë në Kosovë (UNMIK)/Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ) – Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar, miratuar nga qeveria e Kosovës më 10 tetor 2007, si dhe Plani i Veprimit i Qeverisë së Kosovës për Strategjinë e riintegritimit të personave të riatdhesuar, prill 2008. Për diskutim të mëtutjeshëm të Strategjisë së vitit 2007, shih Raportin e OSBE-së: *Zbatimi i strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, fusnota 2, më lart.

<sup>9</sup> Ministrinë kryesore janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

<sup>10</sup> Këto janë Komisioni Evropian (KE), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe UNHCR.

personave të riatdhesuar, duke përfshirë hartimin, propozimin dhe menaxhimin e buxhetit për zbatim (kryesisht të fondit qendror për riintegrim, të shtjelluar më poshtë) dhe vendosja e fushave të përgjegjësive për të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe komunal. Po ashtu, ai është përgjegjës për themelimin e mekanizmave efektivë për shpërndarjen e informatave në institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal. Për më shumë, ai është përgjegjës për bashkërendimin e zbatimit të strategjive qeveritare në nivel qendror dhe lokal, por edhe të mundësimit të bashkëpunimit më donatorët e mundshëm dhe palët tjera. Për të lehtësuar ekzekutimin e mandatit të tij, bordi ekzekutiv shërbehet nga dy institucione vartëse; një zyrë për riintegrim, me lokacion në Departamentin për Shtetësi, Migrim dhe Azil (DSHMA) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe një sekretariat.<sup>11</sup>

## **B) Rishikimi i kornizës së politikës për riintegrimin e personave të riatdhesuar**

Mes vendimeve të para të bordit ekzekutiv ishte krijimi i një grupi ndërmintor pune për të bërë një vlerësim të mekanizmave të vendosur për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Rekomandimet e rëndësishme të dhëna në bazë të vlerësimit ishin rishikimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar të tetorit 2007, themelimi i një fondi për riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe përforcimi i kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe lokale në menaxhim më efektiv të procesit të riintegrit. Vlerësimi gjithashtu rekomandonte që bashkëpunimi ndërinstytucional në nivelin qendror dhe lokal të përmirësohej si dhe që komunikimi me vendet nikoqire të avancohet, sidomos në lidhje me këmbimin direkt të informatave mbi personat që planifikohen të riatdhesohen drejt Kosovës.<sup>12</sup>

Në bazë të këtij vlerësimi, në maj të vitit 2010, qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Strategjia e Rishikuar)<sup>13</sup>, e cila përshkruan politikat dhe masat që duhen marrë për sigurimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për persona të riatdhesuar në fushat kryesore të regjistrimit civil, shëndetësisë, arsimit, punësimit, mirëqenies sociale, banimit dhe çështjeve pronësore. Strategjia e rishikuar gjithashtu ofron kornizën institucionale për menaxhimin e pranimit dhe riintegrit të personave të riatdhesuar. Ajo definon rolet dhe

---

<sup>11</sup> Zyra për riintegrim është ekip i shtatë zyrtarëve me bazë në DSHAM, dhe është pika kontaktuese e nivelit qendror për çështjet e riintegrit. Përgjegjësitë kryesore të saj përfshijnë: mbajtjen e kontakteve të rregullta me zyrtarët komunalë, organet qendrore dhe aktorë të tjerë që punojnë në riatdhesim; ofrimin e trajnimeve për zyrtarët komunalë për politika dhe mundësi relevante të financimit; procedimin preliminar të kërkesave për fondet për riintegrim para parashtrimit të tyre në sekretariat dhe bord ekzekutiv; si dhe kontaktim me personat e riatdhesuar. Një nënkomponentë e kësaj zyre është ekipi për monitorimin e aeroportit, e cila është e pajisur me staf në baza ad hoc, që janë katër nga zyrtarët e ZK-së, si dhe me zyra në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës për të mbledhur të dhëna përkatëse nga personat e riatdhesuar pas kthimit të tyre (p.sh., informata themelore personale, komuna e destinimit) si dhe për t'i ofruar atyre ndihmë të menjëhershme (p.sh. në lidhje me qasjen në banim, regjistrim civil dhe shërbime themelore). Sekretariati është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të institucioneve përkatëse, monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Korrigjuar dhe Planit të Veprimit (shih pikat 13 dhe 15, infra), shtjellimin e rekomandimeve për bordin ekzekutiv, si dhe përpunimin e kërkesave administrative që kanë të bëjnë me kërkesat e dorëzuara nga të kthyerit për të siguruar përfitimet e vëna në dispozicion nga fondi për riintegrim.

<sup>12</sup> Shih: Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, *Vlerësimi i mekanizmave për riintegrimin e personave të riatdhesuar: Sigurimi i trajtimit më të mirë të mundshëm dhe respektimit të të drejtave të njeriut për gjithë personat e riatdhesuar*, prill 2010.

<sup>13</sup> Vendimi i Qeverisë nr. 4/126, 26 maj 2010.

përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale në secilën fazë të procesit të riintegrit, si dhe përcakton procedurat dhe mekanizmat e bashkërendimit për të trajtuar nevojat dhe për të promovuar të drejtat e personave të riatdhesuar. Vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave të komuniteteve joshumicë si dhe grupeve të cenushme.<sup>14</sup>

Më vonë, është hartuar Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar (Plani i Veprimit)<sup>15</sup>. Ai përcakton veprimet e veçanta që duhen ndërmarrë nga institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe lokal, në lidhje me zbatimin e kornizave ligjore dhe të politikave për migrimin, riatdhesimin dhe riintegrimin; ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale; komunikimin dhe bashkërendimin; si dhe ofrimin e shërbimeve në fushat e identifikuar nga Strategjia e Rishikuar brenda afateve të caktuara. Për më tepër, ai parashikon themelimin e një fondi për riintegrim, si dhe siguron mekanizmat monitorues dhe kontrollues në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Rishikuar.

### **C) Themelimi i fondit qendror të riintegrit**

Në përputhje me Planin e Veprimit, fondi i riintegrit është krijuar me vendim të Kryeministrit më 2010<sup>16</sup>, derisa fondet buxhetore janë ndarë më 2010 dhe 2011, për të mbështetur zbatimin e Strategjisë së Rishikuar.<sup>17</sup> Qëllimi i fondit është t'u sigurojë ndihmë direkte humanitare personave të riatdhesuar në nevojë (transport, strehim të përkohshëm, ushqim dhe gjëra jo-ushqimore), si dhe t'i mbështesë ata me vendqëndrim dhe riintegrim socio-ekonomik. Ndarja e fondeve të duhura është çelës në të siguruarit që iniciativat t'i përshtaten në mënyrë të mirëfilltë nevojave të të riatdhesuarve, në fushat prioritare të identifikuar në Strategjinë e Rishikuar dhe Planin e Veprimit. Siç është cekur më lart, fondi administrohet nga bordi ekzekutiv, i cili shqyrton dhe miraton kërkesat për ndihmë nga personat e riatdhesuar në nevojë.<sup>18</sup>

## **3. ZHVILLIMET INSTITUCIONALE NË NIVEL LOKAL**

Në nivelin lokal, janë bërë përpjekje për të përforcuar mekanizmat përkatës institucionalë, të ndërtuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, të kthyerve dhe të riatdhesuarve. Përpjekjet e tilla synojnë të pajisin zyrtarët përkatës komunalë me mbështetjen e domosdoshme financiare, administrative dhe politike, për t'iu mundësuar atyre të përmbushin përgjegjësitë e tyre të përditshme në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe të kthyerve, të vullnetshëm dhe me forcë.

<sup>14</sup> Kjo janë viktimat e trafikimit, amvisëritë me një prind, fëmijët pa kujdestarë, fëmijët me nevoja të veçanta, të moshuarit pa kujdestarë, si dhe personat me aftësi të kufizuara. Shih: Kapitulli 4, "Grupet e cenushme", Strategjia e Rishikuar.

<sup>15</sup> Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, tetor 2010.

<sup>16</sup> Vendimi i Qeverisë nr. 4/126, 26 maj 2010.

<sup>17</sup> Në vitin fiskal 2010, është zotuar fondi prej 500,000 Euro për këtë qëllim, gjersa sipas qeverisë 3.4 milionë Euro janë ndarë për vitin 2011.

<sup>18</sup> Shih fusnotën 11, më lart.

## A) Rregullorja për Zyrat komunale për Komunitete dhe Kthim

Në gusht të vitit 2010, qeveria miratoi Rregulloren për Zyrat komunale për Komunitete dhe Kthim (Rregullorja)<sup>19</sup>, një mekanizëm thelbësor mandator i dizajnuar të mbrojtë dhe promovojë të drejtat e komunitet, duke përfshirë personat e zhvendosur dhe të kthyerit. Rregullorja kërkon që gjitha komunat të themelojnë zyrat e tyre komunale për komunitete dhe kthim, për të ofruar një kornizë adekuate administrative për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, për të siguruar qasje të barabartë të komuniteteve ndaj shërbimeve publike, si dhe për të krijuar kushte për kthim dhe integrim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar. Zyra zëvendëson strukturat e mëparshme komunale, gjegjësisht zyrat komunale të komuniteteve dhe pozitën e zyrtarit komunal të kthimit, me qëllim të lehtësimit të zbatimit konsistent të politikave qeveritare dhe kornizave normative të fushave të mbrojtjes së komuniteteve, kthimit dhe riintegritit.<sup>20</sup>

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës komunale për komunitete dhe kthim janë këshillimi dhe ndihma për institucionet komunale përkatëse dhe ofruesit tjetër të shërbimeve publike në lidhje me zbatimin e politikave qeveritare për komunitetet joshumicë, bashkë me theksin e veçantë tek politikën dhe çështjet e kthimit dhe riintegritit. Zyra është përgjegjëse për vlerësimin e nevojave të të kthyerve dhe personave të riatdhesuar; organizimin e vizitave në terren; promovimin e vetëdijesimit për politikën ekzistuese mes zyrtarëve përkatës dhe përfaqësuesve të komuniteteve; lehtësimin e qasjes ndaj shërbimeve publike; si dhe hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, bashkë me personat e zhvendosur dhe të riatdhesuar. Për më tepër, ajo është përgjegjëse për ofrimin e informatave për të kthyerit mbi të drejtat e tyre dhe strukturat e ndihma mbështetëse e mundshme, si dhe referimi i tyre tek zyrat tjera kompetente brenda administratës komunale. Zyra gjithashtu do të bashkërendojë aktivitetet me institucionet përkatëse komunale dhe qendrore në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe kthimit të qëndrueshëm dhe riintegritit të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.<sup>21</sup>

Komunat janë të obliguara të ndajnë burimet e nevojshme financiare dhe të sigurojnë mbështetje logjistike për zbatimin e Rregullores. Brenda secilës komunë, kryetari dhe udhëheqësi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim mbajnë përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe funksionimin efektiv të zyrës.<sup>22</sup> Përshkrimet e punës dhe termat e referencës që rregullojnë funksionet e zyrës janë aprovuar në korrik 2011, si dhe më pas janë shpërndarë te autoritetet komunale në tërë Kosovën.<sup>23</sup>

<sup>19</sup> Rregullorja Qeveritare nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, miratuar më 12 gusht 2010, që ka hyrë në fuqi më 27 gusht 2010.

<sup>20</sup> Rregullorja bashkon ish-zyrat komunale të komuniteteve dhe pozitën e zyrtarit komunal të kthimit (neni 12, Dispozitat kalimtare të Rregullores; shih edhe nenin 23.10 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, për ndryshim/plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë; si dhe Doracaku i Rishikuar për kthimin e qëndrueshëm, UNMIK/IPVQ, korrik 2006, faqe 18-20).

<sup>21</sup> Neni 7 i Rregullores së Qeverisë, nr. 02/2010.

<sup>22</sup> Neni 10.2 i Rregullores së Qeverisë nr. 02/2010. Shih edhe letrën nga Zëvendës Kryeministri për kryetarët e komunave, të datës 17 gusht 2010.

<sup>23</sup> Përshkrimet e vendit të punës dhe termat e referencës janë aprovuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP) më 4 korrik 2011, në pajtim me Rregulloren e MAP-së 03/2010. Duhet të ceket se



## B) Themelimi i Zyrave komunale për komunitete dhe kthim

Para gushtit 2010, zyrat komunale të komuniteteve si dhe zyrtarët komunalë të kthimit ishin vendosur në shumicën e komunave ku jetojnë komunitetet joshumicë.<sup>24</sup> Në përputhje me Rregulloren e Qeverisë për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, këto struktura të vjetra janë duke u zëvendësuar, apo janë duke u themeluar zyra të reja (aty ku nuk kanë ekzistuar më herët) në 29 nga 37 komuna.<sup>25</sup> Megjithatë, vetëm disa komuna deri tani e kanë rregulluar zyrën me statutin e tyre komunal, ashtu siç parashihet me Rregullore.

Për të siguruar funksionim efektiv të zyrave komunale për komunitete dhe kthim, shumica e komunave kanë ndarë burime financiare për ta në buxhetin komunal të vitit 2011, me numrat e personelit dhe resurseve financiare të nevojshme për paga e mëditje, mallra e shërbime, subvencione e transfere, apo shpenzime kapitale. Megjithatë, në shumë raste, buxheti i propozuar nuk është i mjaftueshëm për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara të zyrave.<sup>26</sup> Për shembull, buxhetet e propozuara nuk mbulojnë shpenzimet në implementim të projekteve dhe aktiviteteve specifike sipas politikave qeveritare për riintegrimin e personave të riatdhesuar, apo politikave tjera me qëllim të promovimit apo mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Ndonëse autoritetet komunale mund të bëjnë korrigjim të përkohshëm të kësaj mangësie duke iu qasur fondit të lartcekur të nivelit qendror për riintegrim, një gjë e tillë nuk do të duhej të zëvendësonte zgjidhjen më të qëndrueshme të planifikimit adekuat financiar në nivel lokal.

## 4. PËRPARIMI/NDIKIMI NË NIVEL LOKAL

Në shumë raste, dallimi mes zotimeve politike, si dhe zhvillimeve praktike, vazhdon të pengojë realizimin zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e riatdhesuar. Mungesa e vazhdueshme e zbatimit efektiv të politikave, sidomos në nivel lokal, është kryesisht rrjedhojë e vlerësimeve dhe analizave të pamjaftueshme të situatës në komuna, mungesës së kapaciteteve institucionale për trajtimin e nevojave të personave të riatdhesuar, si dhe mungesë e shfrytëzimit të financimit në dispozicion në nivel

---

neni 12 i Dispozitave Kalimtare të Rregullores së Qeverisë nr. 02/2010 parasheh që: “Zyrtarët e punësuar në Zyrën Komonale të Komuniteteve dhe si Zyrtarë Komunalë të Kthimit, në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të cilët me themelimin e Zyrës vërtetohen të jenë në gjendje të përfshihen në Zyrë, do të vazhdojnë të punojnë me përskrimet e tyre të punës, pagën dhe koeficientin e pozitës, derisa MKK-ja [Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit] të lëshojë përskrime të reja të punës në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores”. I njëjti nen përcakton që ata zyrtarë që vlerësohen të jenë të tepërt do të vazhdojnë marrëdhënien e tyre kontraktuale me komunën, si dhe do të kenë të drejtën e transferimit, në pajtim me procedurat e shërbimit civil në fuqi.

<sup>24</sup> Zyrat Komunale të Komuniteteve janë ruajtur në 26 nga 33 komuna, pas miratimit të ligjit nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, 15 qershor 2008, derisa zyrtarët komunalë të kthimit kanë vazhduar të punojnë në 27 komuna (shih Raportin e OSBE-së *Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve në Kosovë: Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivelin lokal* (Dhjetor 2009), <http://www.osce.org/kosovo/40722> (qasur më 7 korrik 2011).

<sup>25</sup> Nuk ka zyra të tilla në Han të Elezit/Đeneral Janković dhe Kačanik/Kaçanik (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), tri komunat veriore të Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit (rajoni i Mitrovicës/Mitrovica), Junik (rajoni i Pejës/Peć), Malishevë/Mališevo dhe Mamuşa/Mamushë/Mamuşa (rajoni i Prizrenit).

<sup>26</sup> Neni 10.2 i Rregullores së Qeverisë nr. 02/2010. Shih edhe letrën nga Zëvendës Kryeministri për kryetarët e komunave, të datës 17 gusht 2010

qendror. Gjersa disa komuna kanë ndërmarrë masa proaktive për trajtimin e këtyre mangësive, për shembull përmes themelimit të strukturave plotësuese të bashkërendimit<sup>27</sup>, apo lansimit të fushatave për ngritje të vetëdijes për personat e riatdhesuar<sup>28</sup>, shumica e tyre ende nuk kanë hartuar apo zbatuar ndonjë aktivitet konkret në mundësimin e riintegritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në zonën e përgjegjësisë të tyre.

### **A) Vetëdija e përgjithshme e zyrtarëve komunalë mbi politikën, rolet dhe përgjegjësitë**

Ngritja e vetëdijes tek zyrtarët përkatës komunalë në lidhje me kornizën e rishikuar të politikës për riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe puna në zbatimin e saj, janë hapa qenësorë për të siguruar një reagim adekuat nga komunat. Ndonëse autoritetet e nivelit qendror kanë arritur progresi në këtë kuptim, ka nevojë për udhëzime e orientim të mëtutjeshëm për të promovuar përpjekje të koordinuara në ofrimin e ndihmës për personat e riatdhesuar, në të arriturit e riintegritit të qëndrueshëm.

Gjersa intervistat dhe diskutimet fillestare me zyrtarë përkatës komunalë<sup>29</sup> kanë dëshmuar se vetëdijesimi dhe njohuritë në lidhje me Strategjinë e Rishikuar dhe Planin e Veprimit ishin të kufizuara në shumë komuna, ky boshllëk është trajtuar pjesërisht përmes aktivitete të vetëdijesimit dhe të ngritjes së kapaciteteve të kryera nga ana e autoriteteve të nivelit qendror që nga qershori i vitit 2010. Janë bërë përpjekje për të shpërndarë Strategjinë e Rishikuar dhe Planin e Veprimit të zyrtarët përkatës komunalë, për të mbajtur punëtorit dhe diskutime me zyrtarë komunalë lidhur me kornizën e rishikuar të politikave<sup>30</sup>, si dhe për të shpërndarë fletëpalosje mbi të drejtat e personave të riatdhesuar dhe ndihmën në dispozicion për ta<sup>31</sup>. Këto aktivitete janë mbështetur nga OSBE-ja dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë<sup>32</sup>. Një vlerësim

<sup>27</sup> Grupet punuese janë themeluar në komunën e Ferizajt/Uroševac, dhe Vitisë/Vitina; bordi i riatdhesimit është themeluar në komunën e Vushtrisë/Vucitrn, si dhe komisionet e riatdhesimit janë themeluar në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica dhe Rahovecit/Orahovac

<sup>28</sup> Komunat e Gjakovës/Dakovica, Podujevës/Podujevo dhe Vitisë/Vitina kanë ndërmarrë fushata të ngritjes së vetëdijes

<sup>29</sup> Mes zyrtarëve/institucioneve komunale të intervistuar ishin edhe kryetarët, zëvendës-kryetarët për komunitete; drejtorët komunalë të administratës, urbanizmit/kadastrit, arsimit dhe shëndetësisë; zyrat komunale për komunitete dhe kthim; qendrat komunale të regjistrimit civil; zyrat komunale të gjendjes civile; zëvendës-kryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete; komitetet komunale për komunitete; drejtorët e qendrave për mirëqenie sociale dhe zyrat komunale ligjore. Gjitha intervistat janë mbajtur gjatë periudhës së raportimit.

<sup>30</sup> Për shembull, gjatë prillit dhe majit 2011, Ministria e Punëve të Brendshme ka kryer një varg trajnimesh me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në lidhje me kornizën e politikave për integrimin e personave të riatdhesuar

<sup>31</sup> Qeveria e Kosovës, *Udhërrëfyes i riintegritit*, <http://www.mpb-ks.org/?page=2,138> (qasur më 23 gusht 2011) (në dispozicion në pesë gjuhë).

<sup>32</sup> Mes qershorit dhe tetorit 2010, OSBE-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe UNHCR-në, ka organizuar një sërë punëtorish për kthimin e vullnetshëm dhe të detyruar, për njësitë komunale për të drejta të njeriut si dhe zyrtarët komunalë që merren me komunitete dhe kthim në gjithë Kosovën. Ngjashëm, gjatë shkurtit dhe marsit 2011, OSBE-ja, në bashkëpunim me ministrinë dhe organet qeveritare përkatëse, ka organizuar tryeza të rrumbullakëta rajonale me qëllim të ngritjes së vetëdijes së zyrtarëve përkatës komunalë mbi kornizën e politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe mundësimin e dialogut dhe komunikimit mes nivelit qendror dhe atij lokal. Folësit ishin zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe Zyrës për Çështje të

përcjellës në mbarë Kosovën i kryer nga ekipet në terren të OSBE-së në korrik 2011 ka dëshmuar se një pjesë e madhe e komunave të Kosovës kishte pranuar udhëzimet me shkrim për zbatimin e Strategjisë së Korrigjuar të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme<sup>33</sup>, gjersa përfaqësuesit e mbi gjysmës së komunave duket se kanë ndjekur trajnimet mbi riatdhesimin, të organizuar nga autoritetet e nivelit qendror<sup>34</sup>. Përgjithësisht, zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim duken të jenë më të vetëdijshëm për ekzistencën dhe përmbajtjen e dokumenteve përkatëse, si rezultat i seminareve, punëtorive, trajnimeve apo takimeve njoftuese për këto zyra. Ndryshe, zyrtarët e lartë komunalë, në anën tjetër, ende kanë pak njohuri, apo përkushtim, ndaj politikave ekzistuese, edhe pse ka pasur një rritje të numrit të aktiviteteve të sensibilizimit, për drejtorët e drejtorive komunale në veçanti. Me disa përjashtime<sup>35</sup>, zyrtarët e lartë të intervistuar kanë deklaruar që nuk kanë marrë kopjen e Strategjisë së Rishikuar apo Planit të Veprimit, si dhe nuk kanë qenë të njoftuar me përmbajtjen e asnjërit dokument. Shumica kanë bërë me gisht kah zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim, si persona kryesorë kontaktues për çështjet e ndërlidhura me riintegrimin në nivel lokal.

Vlerësimi i OSBE-së i kryer në korrik 2011 gjithashtu ka përcjellë angazhimet e autoriteteve të nivelit qendror në përmirësimin e vetëdijes komunale lidhur me fondin e riintegritimit dhe qasjes në të. Rezultatet kanë treguar se përpjekjet e Ministrisë së Punëve të Brendshme për t'i shpërndarë kriteret e financimit të zyrat komunale për komunitete dhe kthim (aty ku ato janë të themeluara) apo organet tjera përkatëse ishin kryesisht të suksesshme, ku 30 komuna kanë konfirmuar pranimin e kriterëve, si në kopje fizike ashtu dhe në format elektronik.<sup>36</sup>

---

Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit. Gjatë tryezave të rumbullakëta, janë shpërndarë për pjesëmarrësit kopje të Broshurës së OSBE-së për zyrtarët komunalë për pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar (dhjetor 2010).

<sup>33</sup> Sipas shënimeve të OSBE-së, 29 nga 37 komuna kanë raportuar se kanë pranuar udhëzimet: Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina (rajoni i Gjilanit /Gnjilane), Leposavić/Leposaviq, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan (rajoni i Mitrovicës/Mitrovica), Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik/Junik, Kline/Klina, Pejë/Peć (rajoni i Pejës/Peć), Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Graçanicë, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilic, Shtime/Štimlje (rajoni i Prishtinës/Priština), Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Suharekë/SuvaReka (rajoni i Prizrenit).

<sup>34</sup> Përfaqësuesit nga 20 komuna kanë raportuar se kanë ndjekur seancat e trajnimit të organizuara nga autoritetet e nivelit qendror. Ato ishin Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), Vushtrri/Vučitrn (rajoni i Mitrovicës/Mitrovica) Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik/Junik, Kline/Klina, Pejë/Peć (rajoni i Pejës/Peć), Podujevë/Podujevo (rajoni i Prishtinës/Priština), Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Prizren, Suharekë/ SuvaReka (rajoni i Prizrenit). Duhet të theksohet se kjo shifër është kundërshtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila pretendon se seancat e trajnimit janë ndjekur nga përfaqësuesit e të gjitha komunave, përveç atyre të sapo themeluara, komunat veriore dhe Mamusa/Mamusha/Mamuša.

<sup>35</sup> Për shembull, kryetari i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje; zëvendës-kryetarët për komunitete në Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica dhe Skenderaj/Srbica; drejtorët e drejtorive të administratës në Ferizaj/Uroševac, Vushtrri/Vučitrn, Gillogoc/Glogovac, Podujevë/Podujevo dhe Prishtinë/Priština; drejtorët e drejtorisë së arsimit në Han të Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Podujevë/Podujevo dhe Prishtinë/Priština; drejtorët e drejtorisë së urbanizimit në Mitrovicë/Mitrovica; si dhe drejtori i qendrës për mirëqenie sociale në Dragash/Dragaš.

<sup>36</sup> Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Kline/Klina, Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Novobërdë/Novo Brdo,

## **B) Bashkërendimi dhe bashkëpunimi në nivelin lokal dhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal**

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi efektiv në nivelin lokal dhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është parakusht për zbatimin e suksesshëm të politikave ekzistuese, që kanë për synim lehtësimin e riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Mekanizmat bashkërendues duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat për riintegrim, monitorojnë zbatimin e tyre, bashkërendojnë aktivitetet e të gjithë akterëve të përfshirë.<sup>37</sup>

Përafërsisht, në gjysmën e komunave, zyrtarët e caktuar në kuadër të zyrës komunale për komunitete dhe kthim bashkërendojnë aktivitetet që kanë të bëjnë me riintegrimin e personave të riatdhesuar.<sup>38</sup> Në komunat tjera, caktimi i koordinatorëve ose zyrtarëve për kthim është në pritje të themelimit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Ndonëse disa komuna kanë shkuar përtej fushëveprimit të kornizës së politikave dhe kanë themeluar struktura plotësuese bashkërenduese – më të dalluarat komisionet ad hoc të riatdhesimit në komunat Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Ferizaj/Uroševac dhe Viti/Vitina, si dhe bordi i riatdhesimit në Vushtri/Vuçitrn – në shumicën e rasteve, çështjet që kanë të bëjnë me riintegrimin e personave të riatdhesuar janë diskutuar në mekanizmat ekzistues, siç janë grupet komunale për kthim.<sup>39</sup> Zyrtarët e lartë komunalë, përfaqësuesit e organeve tjera komunale, personat e riatdhesuar dhe komuniteti pritës shpeshherë nuk marrin pjesë nëpër këto forume. Zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim ia përcjellin informatat departamenteve përkatëse komunale kur nevojitet, ndërsa personat e riatdhesuar shpeshherë ndihmohen në baza ad hoc.<sup>40</sup> Aty ku janë të krijuar dhe funksionojnë organet që merren me kthimin, shpeshherë mungon bashkëpunimi ndërmjet këtyre organeve dhe palëve tjera që janë përgjegjëse për çështjet e komuniteteve.<sup>41</sup> Bashkërendimi i dobët ndërmjet organeve përkatëse dhe mekanizmave lokalë mund të pengojnë zbatimin e nismave dhe masave në nivelin lokal. Në shumë raste, këtyre mekanizmave u mungon kapaciteti, burimet dhe/ose mbështetja politike për zbatimin e çfarëdo lloji të masave për mbështetje.

---

Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), Leposavić/Leposaviq, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Vushtri/Vuçitrn, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan (rajoni i Mitrovicës/Mitrovica), Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik/Junik, Pejë/Peć (rajoni i Pejës/Peć), Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilic, Shtime/Štimlje (rajoni i Prishtinës/Priština), Dragash/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Rahovec/Orahovac, Suharekë/SuvaReka (rajoni i Prizrenit).

<sup>37</sup> Shih nenin 7 të Rregullores së Qeverisë, nr. 02/2010.

<sup>38</sup> Për shembull, në Kamenicë/Kamenica dhe Štrpce/Shtërpçë (rajoni i Gjilanit/Gnjilane); Mitrovica/Mitrovica jugore, Vushtri/Vuçitrn, Skenderaj/Srbica, Leposavić/Leposaviq (Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica); Gjakovë/Đakovica, Pejë/Peć dhe Klinë/Klina (Rajoni i Pejës/Peć); Gračanica/Gračanicë dhe Obiliq/Obilic (Rajoni i Prishtinës/Priština); Suharekë/Suva Reka, Rahovec/Orahovac, Dragash/Dragaš dhe Prizren (Rajoni i Prizrenit).

<sup>39</sup> Grupet punuese komunale për kthim janë themeluar në kuadër të Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK)/Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) si forume koordinuese dhe të zbatimit në nivel lokal për çështjet, projektet dhe aktivitetet (vullnetare) të lidhur me kthimin (shih Doracakun i rishikuar për kthim të qëndrueshëm i UNMIK/IPVQ, korrik 2006).

<sup>40</sup> Për shembull, komuna e Gjakovës/Đakovica ka themeluar bazën e të dhënave për regjistrimin e informatave mbi personat e riatdhesuar dhe nevojat e tyre. Megjithatë, në kohën e shkruarjes, kjo bazë e të dhënave nuk është përdorur edhe nga drejtoritë komunale.

<sup>41</sup> Shih gjithashtu, raportin e OSBE-së mbi *Reagimet komunale ndaj zhvendosjes dhe kthimit në Kosovë*, Nëntor 2010, <http://www.osce.org/sq/kosovo/73855> (e qasur më 7 korrik 2011).

Përcjellja e dobët e informatave dhe bashkërendimi i dobët ndërmjet nivelit qendror dhe lokal i rëndon edhe më shumë këto sfida. Siç është cekur më lartë, institucionet e nivelit qendror i kanë ofruar disa udhëzime institucioneve të nivelit lokal për atë se si të zbatohen politikat përkatëse ose për qasjen në fondet e programeve të përcaktuara për të ndihmuar riintegrimin e personave të riatdhesuar.<sup>42</sup> Megjithatë, shumë komunave iu duhet që ende të vendosin komunikimin zyrtar dhe kanalet e informimit lidhur me riintegrimin e personave të riatdhesuar me ministritë përkatëse të linjës.<sup>43</sup> Në fund të vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011, disa zyrtarë nga zyra komunale për komunitete dhe kthim kanë pranuar për herë të parë tabelën me të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme, që përmban informata për personat e riatdhesuar në komunat e tyre, të shoqëruar me kërkesën që institucionet komunale përkatëse ta ndihmojnë riintegrimin e tyre. Për shembull, në mes të janarit 2011, zyrtari komunal për kthim në Mitrovicë/Mitrovica ka pranuar të dhëna për pesë persona të riatdhesuar me forcë në komunë. Ministria ka kërkuar që zyrtari të takohet me ata dhe të plotësojnë formularin me informata shtesë. Fatkeqësisht, detajet kontaktuese mungonin ose ishin të pasakta dhe zyrtari për kthim nuk ka mundur t'i vendosë personat në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, zyrtari për kthim i Fushë Kosovës/Kosovo Polje ka deklaruar, që në dhjetor të vitit 2010 ka pranuar informata për 96 persona të riatdhesuar në komunë. Zyrat komunale për komunitete dhe kthim në Prizren dhe Gjilan/Gnjilane, gjithashtu kanë raportuar, që janë informuar për riatdhesimin e personave, një ditë pas arritjes së tyre në Kosovë. Kryesuesi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim në komunën e Lipjanit/Lipjan kanë raportuar se kanë pranuar një listë prej 279 individëve nga Ministria e Punëve të Brendshme të ishin riatdhesuar në komunë ndërmjet janarit dhe qershorit 2011. Deri më sot asnjë nga komunat nuk kanë raportuar se kanë pranuar njoftim paraprak të arritjes së personave të riatdhesuar dhe, prandaj, asnjëra nga to nuk ishte në gjendje të bëjë organizimet e nevojshme për plotësimin e nevojave të tyre para se të kthehen.

### **C) Mirëmbajtja e bazës së të dhënave/mbledhjes së të dhënave**

Ofrimi me kohë dhe efektiv i ndihmës dhe mbrojtjes së personave të riatdhesuar kërkon të dhëna të besueshme, si dhe vlerësim të saktë afatgjatë të qëndrueshmërisë së procesit të riatdhesimit dhe aktiviteteve të ndërlidhura planifikuese. Zyrat komunale për komunitete dhe kthim duhet ta mirëmbajnë bazën e të dhënave për personat e riatdhesuar, ku duhet të përfshihen të dhëna themelore personale dhe ndonjë nevojë e veçantë e personave të riatdhesuar.<sup>44</sup> Në këtë drejtim, zyra duhet të bëjë bashkërendim të ngushtë me ministritë përkatëse për të siguruar, që informatat të pranohen para arritjes së personave të riatdhesuar, në mënyrë që t'i adresohen nevojave të tyre në mënyrë adekuate dhe me kohë.

Zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim, në 20 prej 37 komunave mbledhin informata për personat e riatdhesuar me qëllim që të planifikojnë aktivitetet e

<sup>42</sup> Shih përgjithësisht Nenin 4(A), “Vetëdijesimi i përgjithshëm i politikave, roleve dhe përgjegjësi tek zyrtarët komunalë” më lartë.

<sup>43</sup> Në shumicën e rasteve, zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim dhe/ose kryetarët e komunave i kontaktojnë ministritë përkatëse për informata në baza *ad hoc*. Nuk duket të ketë mekanizma për shpërndarje të rregullt të informatave.

<sup>44</sup> Shih nenin 7(2) të Rregullores së qeverisë nr. 02/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim, 12 gusht 2010.

riintegrimin dhe monitorimin e të kthyerve.<sup>45</sup> Informatat e mbledhura dhe metodologjia e përdorur dallon nga komuna në komunë, ku pjesa dërmuese e komunave kanë regjistruar vetëm informata për familjet dhe individët, të cilët i qasen direkt administratës komunale. Për shembull, në Gjakovë/Đakovica, zyrtari komunal për kthim mban bazën e të dhënave, ku përfshihen informata siç janë: data e kthimit, numri i të kthyerve, gjendja e tyre shëndetësore, gjendja pronësore dhe ndonjë kërkesë që ata mund të ia kenë dorëzuar autoriteteve apo organizatave joqeveritare (OJQ-ve). Në mënyrë të ngjashme, zyrtari komunal për kthim i Leposavić/Leposaviqit, mban të dhënat (emri, data e lindjes, banimi aktual dhe kushtet e shtëpisë së tyre) e të gjithë personave, të cilët janë riatdhesuar në komunë, në një fletore. Në Obiliq/Obilić, zyra komunale për komunitete dhe kthim mban disa shënime për vlerësimin e mëhershëm të personave të dhe familjeve të riatdhesuara, të cilat iu kanë qasur kësaj zyre. Në Pejë/Peć, zyrtari për kthim së bashku me zyrën për komunitete dhe kthim regjistrojnë vizitat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në tabela, të cilat i ndajnë me të gjithë zyrtarët e zyrave komunave për komunitete dhe kthim. Në pjesën dërmuese të rasteve, megjithatë, informatat e regjistruara kufizohen në informata themelore personale si: vendbanimi, data e kthimit dhe vendi i riatdhesimit dhe nuk lejon prodhimin e të dhënave të zbërthyer ose statistikave për qëllime planifikimi. Vetëm tre komuna kanë raportuar të kenë pasur raste të personave të riatdhesuar me forcë gjatë periudhës për të cilën po raportohet dhe si të tillë, nuk mbajnë të dhëna.<sup>46</sup>

#### **D) Identifikimi i nevojave prioritare dhe zhvillimi i strategjive, programeve dhe procedurave komunale**

Nga komunat kërkohet që t'i qasen dhe të mbajnë kontakte të rregullta me komunitetin e kthyer dhe atë pritës, si dhe të vlerësojnë nevojat e veçanta të të kthyerve aktual dhe potencial në komuna, në mënyrë që të mundësohet zbatimi efektiv i politikave dhe strategjive, që kanë për synim lehtësimin e riintegrimin.<sup>47</sup>

Vlerësimi i OSBE-së i kryer në korrik 2011 ka dëshmuar se gati gjysma e të gjitha komunave kanë ndërmarrë aktivitetet informuese me personat e riatdhesuar në fushën e tyre të përgjegjësisë<sup>48</sup>. Për shembull, zyrtarët në Skenderaj/Srbica dhe Leposavić/Leposaviq kanë kryer vizita informimi për mbledhjen e të dhënave përkatëse për familjet e riatdhesuara shqiptare dhe rome të Kosovës, respektivisht pas arritjes së tyre në komuna. Komuna e Gjakovës/Đakovica, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka organizuar vizitë informimi për mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e nevojave të disa familjeve egjiptiane të Kosovës, të riatdhesuara nga Franca, Gjermania dhe Suedia. Në komunat tjera, duke përfshirë

<sup>45</sup> Ferizaj/Uroševac, Gjiilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Štrpce/Shtërpçë dhe Viti/Vitina (Rajoni i Gjiilanit/Gnjilane); Gjakovë/Đakovica, Deçan/Deçane, Pejë/Peć, Istog/Istok dhe Klinë/Klina (Rajoni i Pejës/Peć); Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanicë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić dhe Shtime/Štimlje (Rajoni i Prishtinës/Priština); Rahovec/Orahovac, Dragash/Dragaš dhe Prizren (Rajoni i Prizrenit) dhe Leposavić/Leposaviq (Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica).

<sup>46</sup> Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Podujevë/Podujevo.

<sup>47</sup> Shih nenin 7 të Rregullores së qeverisë nr. 02/2010.

<sup>48</sup> 16 komuna kanë raportuar së kanë kryer aktivitetet informuese me personat e riatdhesuar: Kline/Klina, Klokot-Vrbovac/Kllkot-Vërboc, Partesh/Partesh, Štrpce/Shtërpçë (rajoni i Gjiilanit/Gnjilane), Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik/Junik, Pejë/Peć (rajoni i Pejës/Peć), Gračanica/Gračanicë, Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje (rajoni i Prishtinës/Priština), Prizren, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina (rajoni i Prizrenit).

Kamenicën/Kamenica, Klokot-Verbovac/Kllokotin-Vërbocin, Gračanica/Gračanicën dhe Prizrenin, zyrtarët për komunitete dhe kthim takohen rregullisht me personat e riadhesuar për të mbledhur informata për nevojat e tyre dhe për të kryer vizita të mëtutjeshme ku është e nevojshme. Komuna e Podujevës/Podujevo, Gjakovës/Dakovica dhe Vitisë/Vitina gjithashtu kanë ndërmarrë fushata të ngritjes së vetëdijes. Megjithatë, këto aktivitete duket se kanë ndodhur ad hoc apo në mënyrë sporadike.

Një vlerësim gjithëpërfshirës dhe domethënës i nevojave është edhe më tej një hap i parë thelbësor para planifikimit, zbatimi ose vlerësimit efektiv të projekteve dhe aktiviteteve që mund të zënë vend, por deri më sot, asnjëra komunë nuk ka bërë vlerësim të tillë dhe/ose nuk ka hartuar politika ose përgatitur plane përkatëse të veprimit në fushën e kthimit dhe riintegritimit për personat e riadhesuar. Mungesa e informatave të besueshme paraprake për kthimin, e bënë edhe më të vështirë për komunitetet që të zhvillojnë strategji dhe programe ose përpilojnë listat të sakta të përfituesve për qëllime të ndihmës, duke marrë parasysh madhësinë e familjeve, nevojat e veçanta dhe kriteret e cenueshmërisë siç parashihen me kornizën ekzistuese të politikave. Për më tepër, siç është përmendur më lartë, financimi në nivel lokal është shpesh i pamjaftueshëm për mbështetjen e projekteve ose programeve domethënëse. Deri më tani, asnjë komunë nuk ka ndarë fonde në buxhetin përkatës komunal për zbatimin e masave të veçanta, të parapara me Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit.<sup>49</sup>

#### **E) Masat për ndihmë të ndërmarrë nga komunitetet**

Në Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit përkatës rekomandohen që të merren masa konkrete nga autoritetet përkatëse për t'i adresuar sfidat e identifikuar për riintegrim<sup>50</sup>, në fushat siç janë: regjistrimi civil, arsimi, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale dhe banimi. Megjithatë, përkundër ndarjes së një shumë të konsiderueshme të ndihmës përmes fondit të nivelit qendror, deri më sot komunitetet kanë bërë përpjekje të kufizuara për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve ose zhvillimin e nismave konkrete në këtë drejtim. Të dhënat e grumbulluara gjatë vlerësimit të OSBE-së në korrik 2011 kanë treguar se rreth 160 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet komunale te autoritetet e nivelit qendror për alokime të Fondit për Riintegrim, duke përfshirë kërkesa për ndihmë humanitare (ushqim, artikuj joushqimorë), banim, ndihmë mjekësore, gjenerim i të ardhurave, etj. Burimet e nivelit qendror kanë cekur se kjo shifër ishte 173, ku 102 kërkesa/projekte janë aprovuar nga bordi ekzekutiv. Megjithatë, gjersa numri i kërkesave të suksesshme duket se është rritur në muajt e fundit, duhet të theksohet se gjatë vlerësimit të korrikut, OSBE-ja ka pranuar ankesa nga autoritetet komunale që pretendojnë se procesi merr kohë të paarsyeshme të gjatë apo janë refuzuar pa arsyetim nga bordi ekzekutiv.

**Regjistrimi civil**, vazhdon të jetë një prej brengave kyçe për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Një numër i komunave<sup>51</sup> raportojnë të kenë marrë hapa për

<sup>49</sup> Shih gjithashtu seksionin 3 të këtij raporti, “Zhvillimet institucionale në nivelin lokal”, më lartë.

<sup>50</sup> Shih Planin e veprimit, kapitulli 4, “shërbimet e garantuara”.

<sup>51</sup> Mitrovicë/Mitrovica dhe Skenderaj/Srbica (Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica), Kamenicë/Kamenica dhe Štrpce/Shtërpçë (Rajoni i Gjilanit/Gnjilane), Kline/Klina dhe Istog/Istok (Rajoni i Pejës/Peć),

lehtësimin e regjistrimit civil dhe lëshimin e dokumenteve dhe certifikatave për personat e riatdhesuar të këtyre komuniteteve. Këto nisma përfshijnë: ofrimin e udhëzimeve dhe këshillave të përgjithshme për procedurat e regjistrimit civil<sup>52</sup>; bashkëpunimin me partnerët implementues të UNHCR-it për ndihmë juridike dhe organizatave tjera në lehtësimin e regjistrimit civil për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian<sup>53</sup>; dhe lirin e komuniteteve joshumicë dhe grupet tjera të cenueshme nga pagesa administrative për lëshimin e dokumenteve. Për shembull, në komunat Skenderaj/Srbica, Deçan/Dečane, Junik, Klinë/Klina, Istog/Istok, Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilić dhe Shtime/Štimlje, personat e riatdhesuar nuk paguajnë tarifë administrative për lëshimin e dokumenteve nga zyrat e regjistrimit civil dhe/ose statusit civil. Veç kësaj, disa komuna në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë marrë pjesë në fushatën informuese mbarë kosovare për regjistrimin civil, duke përfshirë shpërndarjen e posterëve dhe fletëpalosjeve mbi procedurat e regjistrimit. Në komunat tjera, nuk është ndërmarrë asnjë veprim i mirëfilltë dhe personat e riatdhesuar në shumë raste nuk konsiderohen kategori e veçantë, e cila ka nevojë për masa të ndihmës së veçantë.<sup>54</sup>

Në fushën e **arsimit**, Strategjia e rishikuar e shoqëruar me planin e veprimit synon të lehtësojë riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar në sistemin arsimor të Kosovës. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, aktivitetet komunale janë përqendruar kryesisht në (apo kufizohen në) ofrimin e informatave mbi mundësitë e arsimit dhe shërbimet në dispozicion, si dhe në udhëzimin mbi procedurat për njohjen e diplomave dhe certifikatave. Në Obiliq/Obilić dhe Rahovec/Orahovac, drejtoritë komunale të arsimit i kanë siguruar informata Ministrisë për arsim, shkencë dhe teknologji, për gjendjen e regjistrimit në shkolla të fëmijëve të riatdhesuar, pas kthimit të tyre. Në rastet tjera, autoritete komunale, në bashkëpunim me ose të mbështetur nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare kanë ndihmuar kthimin e fëmijëve ose rasteve të cenueshme, duke dhuruar tekste shkollore ose materiale tjera mësimore pa pagesë. Për shembull, në Gračanica/Gračanicë, Qendra rome e arsimit – e financuar kryesisht nga OJQ-ja “Balkan Sunflowers” – për fëmijët rom, duke përfshirë personat e riatdhesuar, ka organizuar orë plotësuese në gjuhën serbe, iu ka dhuruar tekste shkollore falas dhe iu ka ndihmuar për regjistrim në shkollë. Në Junik, drejtoria komunale e arsimit është duke mbështetur tre nxënës me nevoja të veçanta, të cilët janë riatdhesuar në vitin 2009, duke iu kompensuar udhëtimet ditore në Prizren, ku gjendet shkolla e tyre. Megjithatë, fëmijët e riatdhesuar, zakonisht trajtohen në baza rast për rast në pjesën dërmuese të komunave, si dhe në asnjë komunë nuk është zhvilluar ndonjë program dhe/ose masë e veçantë për të iu adresuar nevojave të tyre të caktuara për riintegrim.

---

Gračanica/Gračanicë dhe Lipjan/Lipljan (Rajoni i Prishtinës/Priština) dhe Prizren (Rajoni i Prizrenit).

<sup>52</sup> Udhëzimet zakonisht jepen nga zyrat komunale për komunitete dhe kthim, qendrat komunale për regjistrim civil dhe Zyrat komunale për statusin civil, ndërsa vetëm disa zyra kanë bërë përpjekje t'i qasen personave në fjalë, në mënyrë që të mbështesin qasjen në shërbime komunale.

<sup>53</sup> Në emër të UNHCR-it, Programi i OJQ-ve për të Drejtat Civile në Kosovë (P/RCK) ka filluar zbatimin e fushatës, duke pasur për cak komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, në shtator të vitit 2006. Ka përmbyllur memorandume të mirëkuptimit me një numër të komunave për të siguruar fleksibilitet sa i përket procedurave për regjistrim civil dhe lirin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga pagesa e tarifës administrative.

<sup>54</sup> Në Pejë/Peć, P/RCK e ka dorëzuar kërkesën në komunë para disa muajve për lirin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian nga pagesa e tarifës administrative për lëshimin e dokumenteve civile. Edhe në kohën kur po shkruajmë, nuk është marr ende përgjigje në këtë kërkesë.



Për shembull, asnjë komunë nuk ka realizuar ose zbatuar ndonjë projekt të veçantë, siç janë kurset për gjuhë dhe orë plotësuese, për të ndihmuar kështu riintegrimin e fëmijëve të riatdhesuar dhe/ose kufizuar shkallën e braktisjes së shkollës nga ana e tyre.<sup>55</sup>

Lidhur me **shëndetësinë**, Strategjia e rishikuar dhe plani i veprimit, kanë për qëllim të lehtësojnë qasjen e personave të riatdhesuar në sistemin shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë informimin e personave të ndikuar dhe adresimit të nevojave të tyre të veçanta shëndetësore. Në disa komuna, objektet shëndetësore janë në kuadër ose afër lagjeve të komuniteteve joshumicë, ose shërbimet e kujdesit shëndetësor publik janë bërë më lehtë të qasshme për këto komunitete. Për shembull, në komunën e Pejës/Peç, me mbështetjen e OJQ-së italiane Intersos, një ekip mobil i pajisur, që i shërben fshatrave/rretheve të izoluar dhe komuniteteve joshumicë. Disa komuna kanë realizuar fushata për avancimin e kujdesit shëndetësor<sup>56</sup> dhe/ose kanë kryer vizita në terren, vendbanimeve të banuara nga komunitetet joshumicë<sup>57</sup>. Megjithatë, masat në këtë fushë, zakonisht nuk kanë pasur cak personat e riatdhesuar veçanërisht, si dhe deri më sot nuk janë realizuar programe ose nisma të veçanta për adresimin e nevojave të posaçme të personave të riatdhesuar në këtë fushë.

Sa i përket **punësimit dhe mirëqenies sociale**, synimi kryesor i Strategjisë së rishikuar është mbështetja e riintegrit socio-ekonomik të personave të riatdhesuar, duke e lehtësuar kështu qasjen në mundësi të punësimit dhe skema sociale në dispozicion. Megjithatë, në nivelin lokal nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret për zbatimin e masave të veçanta në këto fusha. Pjesa dërmuese e drejtorive komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, qendrave për mirëqenie sociale dhe qendrave rajonale për punësim dhe aftësim profesional i trajtojnë personat e riatdhesuar në mënyrë të barabartë me çdo person tjetër që ka nevojë për mbështetje socio-ekonomike dhe/ose përfitime sociale. Nuk ekzistojnë programe ose masa që kanë për cak në mënyrë të veçantë personat e riatdhesuar. Në vend të kësaj, personat e riatdhesuar shpeshherë udhëzohen të shkojnë tek organizatat ndërkombëtare për mbështetje rreth riintegrit.<sup>58</sup>

Përfundimisht, mungesa e **banimit dhe akomodimit** të personave të riatdhesuar mbetet pengesa kryesore dhe fushë e lënë pas dore për riintegrim të qëndrueshëm, gjë që edhe parashihet me Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit. Në kohën kur po shkruhet, disa komuna kanë ndërmarrë hapa drejtë gjetjes së zgjidhjeve të

<sup>55</sup> Shih gjithashtu UNICEF-i Kosovës dhe Komisioni gjerman për UNICEF-in (Verena Knaus, Peter Widmann), *Integrimi sipas kushteve – Raporti për gjendjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë*, 2010. [http://www.unicef.org/kosovo/RAEstudy\\_eng\\_web.pdf](http://www.unicef.org/kosovo/RAEstudy_eng_web.pdf) (e qasur me 23 gusht 2011).

<sup>56</sup> Në shumicën e rasteve, fushatat për ngritjen e vetëdijes nuk kanë pasur cak, në mënyrë të veçantë personat e riatdhesuar ose të kthyer, por më tepër popullatën në tërësi.

<sup>57</sup> Për shembull në Gjilan/Gnjilane, Viti/Vitina dhe Novo Brdo/Novobërdë.

<sup>58</sup> Drejtori i qendrës rajonale për punësim në Mitrovicë/Mitrovica u përqendrua në byronë për migracion, të themeluar kohëve të fundit, që është në kuadër të Zyrës për punësim, e cila do të përqendrohet në çështjet e personave të riatdhesuar. Kjo zyre është hapur më 9 mars 2011 dhe stafi i saj kanë vijuar trajnimin në Prishtinë/Priština. Kjo zyrë do të informojë personat e riatdhesuar për procedurat dhe mundësitë në dispozicion për punësim. Derisa, personat e riatdhesuar i referohen Zyrës për migracion, për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore, Zyra për migracion do të vazhdojë t'i referojë ata tek Zyra e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim, e cila deri më tani i ka mbështetur personat e riatdhesuar për çështjet e punësimit.

përkohshme ose afatgjate të banimit për personat e riatdhesuar.<sup>59</sup> Strategjitë ekzistuese duhet të shërbejnë si udhëzues për projekte të veçanta, që kanë për synim adresimin e nevojave të banimit për rastet e cënueshme dhe/ose ato pa zgjidhje afatgjate të banimit. Për shembull, komunat nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për zhvillimin e programeve për banim në pajtim me Ligjin për financimin e programeve të veçanta për banim<sup>60</sup> ose nuk kanë dorëzuar propozime institucioneve përkatëse qendrore ose donatorëve për (ri)ndërtimin e shtëpive për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk është raportuar për ndonjë rast nga ana e komunave, që është kërkuar ndihmë përmes skemës së qiradhënies, e cila menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Pronës.<sup>61</sup> Personat e riatdhesuar, në shumë raste gjejnë strehim të përkohshëm tek të afërmit e tyre ose në qendra kolektive dhe në kampe të personave të riatdhesuar, por jo të gjithë gjejnë banim adekuat ose për arsye të ndryshme, jo të gjithë mund të kenë qasje në skema sociale ose të banimit alternativ. Për shembull, në Leposavić/Leposaviq, personat e riatdhesuar jetojnë në fshatin Kamen dhe kampin e romëve, ndërsa disa familje jetojnë në shtëpi të improvizuara. Në Gjilan/Gnjilane, nëntë familje rome janë riatdhesuar me forcë nga vendet e treta në vitin 2010, por pastaj kanë shkuar menjëherë për Bujanovac/Bujanoc, në jug të Serbisë, për shkak të mungesës së banimit dhe asistencës në Kosovë.<sup>62</sup>

## 5. PËRFUNDIME

Strategjia e rishikuar dhe plani i veprimit janë dokumentet kryesore të politikave që i drejtojnë përpjekjet e qeverisë, me synim që të sigurojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate për personat e riatdhesuar. Këto dokumente të politikave kërkojnë përkushtim të ripërtërirë si nga institucionet e nivelit qendror ashtu edhe të atij lokal për të siguruar zbatimin efektiv të tyre.

Deri më sot, është shënuar përparim në fushën e zhvillimit dhe miratimit të dokumenteve për politika që kanë për synim sigurimin e kushteve adekuate për pranim dhe riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Megjithatë, zbatimi mbetet larg nga pritjet, veçanërisht në nivelin lokal. Korniza institucionale, e cila ka për detyrë të mbikëqyrë përpjekjet e bashkërenditura të qeverisë për zbatimin e Strategjisë e rishikuar dhe planin e veprimit tanimë është vënë në jetë, si dhe janë ndarë fondet qeveritare për sigurimin e shërbimeve për riintegrim; megjithatë, përkundër disa përjashtimeve të theksuara, në shumicën e komunave këto zotime ende nuk janë shndërruar në veprime dhe nisma konkrete në shumicën e komunave. Përveç

<sup>59</sup> Në Lipjan/Lipljan, më 20 prill 2011, kryesuesi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim, në marrëveshje me kryetarin e komunës, ia dorëzoi Ministrisë së punëve të brendshme kërkesën për fonde së bashku me projektin e hollësishëm për ndërtimin e tri qendrave kolektive, që do t'i akomodonin personat e riatdhesuar në komunë. Secila qendër do t'i strehojë pesë familje.

<sup>60</sup> Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta për banim, 12 mars 2010.

<sup>61</sup> Ndër detyrat tjera, Agjencia Kosovare e Pronës ka mandat që të mbikëqyrë qiradhënien e pronës së braktisur në Kosovë, menaxhimin e skemës së qiradhënies për pronat nën administrimin e saj. Kjo skemë ia mundëson titullarit të pronës të pranojë të hyra fikse nga prona, duke e autorizuar Agjencinë Kosovare të Pronës për qiradhënie, derisa ai/ajo vendos ta shfrytëzojë pronën në ndonjë mënyrë tjetër. Shih seksionin 1.1(b) të rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore, 15 Nëntor 1999.

<sup>62</sup> Sipas Zyrës për komunitete dhe kthim të komunës së Gjilanit/Gnjilane, shtëpitë e tyre nuk janë të banueshme nga që janë shkatërruar gjatë konfliktit të vitit 1999.

ndihmës për sensibilizim më të madh dhe njohuri më të shumta për zyrtarët përkatës komunalë mbi politikat ekzistuese dhe burimet në dispozicion, është e nevojshme që të vazhdohet fuqizimi i nivelit të komunikimit dhe bashkërendimit ndërmjet nivelit qendror dhe komunal, si dhe ndërmjet komunave, për të siguruar kështu reagime të duhura komunale ndaj nevojave të riintegritit për personat e riatdhesuar. Për më tepër, duhet të sigurohen linja të qarta të përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim të ngushtë me organet dhe mekanizmat përkatës të nivelit qendror, komunat duhet të sigurojnë mbështetje adekuatë për riintegrimin e atyre që kanë nevojë, duke përfshirë qasjen proaktive dhe lehtësimin e qasjes në shërbime për personat e riatdhesuar.

Boshllëqet në ndihmë dhe mbështetje shpeshherë i lënë personat e cenuseshëm pa kujdes adekuat me rastin e arritjes së tyre në Kosovë, si dhe i vënë individët dhe familjet në gjendje të cenusshmërisë së skajshme. Mungesa faktike e ndihmës në fushën e banimit, shkollimit dhe mundësive ekonomike ka pasoja serioze në riintegrimin e qëndrueshëm të komuniteteve, veçanërisht të atyre që kanë nevojë për mbrojtje, duke përfshirë komunitetet joshumicë, gratë dhe fëmijët.<sup>63</sup> Masat e vendosura në të gjitha nivelet e qeverisë nevojiten për përmirësimin e zbatimit të politikave dhe strategjive të riintegritit, me qëllim të sigurimit të kushteve jetësore afatgjate dhe të qëndrueshme për personat e ndikuar.

## **6. REKOMANDIMET**

### **për institucionet e nivelit qendror:**

- Të ripërtërihen zotimet e përcaktuara në Strategjinë e rishikuar dhe Planin e veprimit duke siguruar që burimet adekuatë të jenë në dispozicion në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke vënë theks mbi zyrat e posa-themeluara komunale për komunitete dhe kthim, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, si dhe mbi zbatimin e programeve dhe projekteve që kanë për cak fushat kyçe siç janë: regjistrimi civil, shëndetësia, arsimi, punësimi dhe banimi;
- Të ndërmerren hapat e mëtejme për të siguruar që komunat informohen në mënyrë sistematike dhe në kohë lidhur me ardhjen e personave të riatdhesuar, fushën e tyre të përgjegjësisë dhe procedurat që duhet të ndiqen kur aplikojnë për fonde të riintegritit, të cilat ndahen nga pushteti qendror;
- Në bashkëpunim me hisedarët përkatës ndërkombëtarë, të sigurohet trajnim dhe ngritje e mëtejme e kapaciteteve institucioneve lokale për shtimin e aktiviteteve për informim, aktiviteteve informuese dhe sensibilizimi në lidhje me politikën, strategjitë dhe programet ekzistuese për riintegrim, si dhe të mbështeten komunat në ngritjen e vetëdijes dhe shpërndarjen e informatave mbi të drejtat e personave të riatdhesuar dhe ndihmës në dispozicion;
- Të sigurohet bashkëpunim dhe bashkërendim efektiv ndërmjet ministrive përkatëse përgjegjëse për shëndetësi, arsim, punësim, mirëqenie sociale dhe

---

<sup>63</sup> Shih gjithashtu, Udhëzuesin për kualifikim i UNHCR-së për vlerësimin e nevojës për mbrojtje ndërkombëtare të individëve nga Kosova, sipër shënim 3.

banim, si dhe ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, duke forcuar kështu mekanizmat për bashkërendim dhe komunikim ndërministror.

#### **për komunat:**

- Në pajtim me Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit, të sigurohet bashkëpunim, bashkërendim dhe komunikim efektiv ndërmjet zyrave dhe drejtorive përkatëse komunale dhe institucioneve të nivelit qendror dhe në mënyrë proaktive të kërkojnë informata dhe mbështetje nga ministritë përkatëse në lidhje me përgjegjësitë komunale;
- T'i identifikojnë nevojat më urgjente të personave të cilët kthehen në komunë, si dhe t'i përcaktojnë si duhet prioritetet e aktiviteteve të ndërlidhura, përfshirë përmes ndarjes urgjente të fondeve adekuate dhe veprimit të menjëhershëm mbi të gjitha aktivitetet që nuk janë buxhetuar;
- T'u sigurohet zyrave komunale për komunitete dhe kthim mbështetje adekuate politike, administrative dhe financiare, për të ia mundësuar shkarkimin nga funksionet e tyre;
- Të organizohen aktivitete efektive informimi për personat e riatdhesuar, në mënyrë që të lehtësohet dhe mbështetet kontakti, dialogu dhe shpërndarja e informatave ndërmjet komuniteteve pranuese dhe të kthyerve si dhe ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve.

#### **për bashkësinë ndërkombëtare:**

- UNHCR-ja: të vazhdojë ofrimin e udhëzimeve për autoritetet përkatëse të vendeve pritëse dhe institucioneve të Kosovës për mbrojtjen ndërkombëtare të nevojave të individëve nga Kosova, si dhe të monitorohet procesi i riatdhesimit, për të siguruar kryerjen e tij në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Shtetet pritëse: të kenë konsideratë të duhur për kushtet e pranimit dhe riintegrimin në komunat e Kosovës, para se të marrin vendime për riatdhesim. Nëse pritet të zë vend kthimi, atëherë të sigurohet mbrojtja e plotë e drejtave të personave të riatdhesuar si dhe kthimi të kryhet në mënyrë dinjitoze dhe të sigurt; dhe
- Hisedarët tjerë ndërkombëtarë: të inkurajojnë dhe mbështesin institucionet e Kosovës që plotësisht dhe menjëherë ta zbatojnë kornizën ekzistuese të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar, përfshirë përmes ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve përkatës, sensibilizimit të të gjithë hisedarëve të përfshirë dhe ofrimit të ndihmës teknike institucioneve përkatëse dhe strukturave bashkërenduese.